

ZEJNEPE ALILI REXHEPI

LIRIKA MBIJETESE NË KOHËN E PAKOHË

“Kohë e djegur në bebëza” - Ibrahim Kadriu

821.18-14.09

Sa më gjatë mendon për një kohë të djegur, aq më shumë beson në forcën krijuese të poetit, sa më thellë ta ndiesh verbërinë, aq më larg sheh në dritën e përtejme që nuancohet nga vargje me kahëzime të përjetshme! Mendim ky, që të pushton ndër të parët, përderisa e shfleton antologjinë poetike “Kohë e djegur në bebëza”.

Shkrimtarin e përvijon kultura e përgjithshme. Njihet si poet, vargjet e të cilit përshkojnë “*mote të murosura në dhimbje*”, romancier, që trajton drama njerëzore me fatin e të qenit shqiptar dhe gjithsesi shkrimtar - fjala e të cilit e bart peshën e kohës së pa emër deri në përtejkohë, i përket truallit, ku edhe “*mbi gjethje vjeshte historia qante atëbotë*”... Kjo e skalit portretin e shkrimtarit me dell kombëtar, kur shkruan: “*Askush s'e njeh gjakun tim që rrjedh/ krejt i huaj i mbetur në faqe librash*”¹.

Antologjia “Kohë e djegur në bebëza” është përzgjedhje poezish nga më të bukurat, të sjella vëmendshëm dhe me shumë përkushtim e profesionalizëm nga studuesi i letërsisë arbëreshe Anton Nikë Berisha. Ashtu sikurse pak më vonë, përpilohet edhe vepra “Qasje veprave të Ibrahim Kadriut”², një përzgjedhje analizash e studimesh (nga autorë shqiptarë dhe të huaj).

Në titullin “Kohë e djegur në bebëza” ndihet pushteti i fjalës para kataklizmash shoqërore, ku filozofia poetike del si humanizëm për domosdoshmérinë e së nesërmes. Poeti i derdh në vargje historitë kombëtare që i njeh, për të mos e lënë atë shterpë në rrëpirat e kohës që pamëshirshëm djeg e digjet në bebëza.

Atdheu - metaforë dhembjesh shekullore³

“Kohë e djegur në bebëza” është sajuar nga lirika antologjike, të shkruara në kohë të vështira, megjithëse me vizion të qartë për të nesërmen. Poezitë, këtu qëndrojnë në dy linja të njëtrajtshme rrëfimore: në magjinë e vargëzimit ngritur mbi sfonde historish dhe në botën e shkrimtarit që shpërfaq procesin e konsoliduar intelektual. Pavarësisht se, çdo libër ka mënyrën autoriale të krijimit, ndjeshmëritë e vetëdijshme mbi histori kolektive e bëjnë shkrimtarin udhërrëfyesin më të besueshëm në sytë e lexuesit. Imazhi i tillë e tipizon Ibrahim Kadriun, si figurë intelektuale dhe poet që e strukturon këndshëm frymëzimin, harmoninë e fjalës dhe forcën krijuese.

Krenaria për të shkuarën, dhembja për të sotmen dhe gjakimi për të ardhmen janë harku përvijues tematik i poeziave, të marra nga dhjetëra vepra e të vendosura në ciklet: “Etja e rrënëjëve”, “Mote të murosura në dhembje”, Frymëmarrije në shtjellë”, “Pafundësia e udhëtimit”, “Në vorbullën e vëtmisë”, “E gjuajtëm botën në fund të gotës”, “Etje e zgjuar”, “Të jesh shkrimtar” dhe “Përtej dritares sime”⁴.

Dendësia kuptimore e poeziave përmes episodesh të rrëfyera na shpie te një emër - Atdheu, ky sinor i pa luajtur, varret pa mbishkrime të të cilit “*historisë faqet t'ia shkyejnë/ epikën ta fusin në varr*”, pasi në të

¹ Ibrahim Kadriu, “Kohë e djegur në bebëza”, Prishtinë, 2015.

² Përzgjedhje “Qasje veprave të Ibrahim Kadriut” (nga autorë shqiptarë dhe të huaj), Gjilan, 2015.

³ Zejnepe Alili Rexhepi, “Pas gjurmëve të fjalës”, Tetovë, 2017.

⁴ Ibrahim Kadriu, “Kohë e djegur në bebëza”, Prishtinë, 2015.

“*plagët vazhdojnë të pjellin plague*”. Vetëm dashuria për *Atdhe* vapës së shpirtit të poetit i bën ballë, tek mendon: “*Se si më iku e djeshmjë/ në pritje të përjetshme*”.

I lindur në qytetin e Gjilanit, një vendbanim që fle mbi gërmadha historish, poeti e ka trashëgim krenarinë kombëtare dhe trimërohet nga kujtimet për Idriz Seferin:

“*Në gur emri yt, vetëm në gur
gjen strehim më të mirë të qëndresës;
në gur emri yt, vetëm në gur
mund të flasë legjendën e gjakut, të fortesës
...
Në gur fjala jote, vetëm në gur
...
E flasim me gjuhën tënde,
të urtët kurrë s’do të ndiejnë lodhje;
...
Në gur pesha jote, vetëm në gur*” (54)¹.

Kulti për tokën, heronjtë dhe historitë e përgjakura e ngjyejnë penën e Ibrahim Kadriut, me dashurinë për *Atdhe* e me *durimin e mbëltuar* në gjak megjithëse, jo rrallë, pena e tij teksha ndeshet me dhembjen për këtë tokë, mbetet *fillikat me dëshpërimin*. Guri, përjetësish mbetet simbolika e qëndresës ndër shekuj, në traditën shqiptare.

Bota emotive plot rëndesa e shqetësime e bën të prekshme jetën në çdo çast të rrymimit të saj, në truallin shqiptar dhe gjetiu ku të ndjell e të shtjell fati. Thyerjet shpirtërore, përpos notash nostalgjike, sajohen me elegancë poetike, ndonëse të ngritura mbi binarët e dhembjes, siç pohon poeti: “*Në Kosovë kur arrin e ke të cunguar historinë*”. Dhimbeje kjo deri në ironi për të vijuar më pas (strofa e dytë) në po të njëjtën poezi:

“*Rrëfimet e ethshme formohen
me ilustrime të ditës
shfaqjet merren me etje të pa shuar
dhe me uri ujku
rrëfimtarët për çdo natë
i thonë të njëjtat ninulla
duke na vënë në gjumë të gjatë
deri te rrëfimet e tjera*”
“*Me dyer hapur*” (36-37)².

Faqet e historisë së këtij kombi janë përplot rëndesa kohe, tragjedi e furtuna që mezi i bartin faqet e shkruara, prandaj, “*Kosova s’mund të harrojë*”, sepse “*Rrëfimtarët për çdo natë/ i thonë të njëjtat ninulla*” (36 - 37)³.

¹ Ibrahim Kadriu, “Kohë e djegur në bebëza”, Prishtinë, 2015, f. 54.

² Po aty, f. 36 - 37.

³ Po aty.

Gjakimi i poetit është Kosova - tokë e tij, ku për mijëra shpirtra, ëndrrat për liri digjeshin si fluturat në gjuhëza flakësh, andaj në këtë tokë ethe dhe etje kanë edhe rrënjet. Po “Kosova ka urti” (35) në pritje të përbushjes së asaj “Gjeografie të etur” drejt Shqipërisë, meqë *Atdheu* duhet të ketë përmasa të tjera:

“*Shqipëri është edhe ku s’është*

Më kot është ndrydhur harta

Është tkurrur atdheu në acar

Hartat mund të shqyhen” (34)¹.

Nuk ka si të ndihet ndryshe një shkrimtar që koha i digjet në bebëza përderisa sheh “në teatrin antik të përbuzjes së një kombi” kur në rrugëtime shekujsh shikimet mbeten përfjetësisht të gurëzuara.

“*Toka ime me nëmë*

e vënë nën këmbë

të shekujve të shfrenuar

e lënduar shpirtërisht dhe e mbështetur

në durimin tim të gjatë“ (31)².

Atdheu, për poetin, është sinonim ngrehinash të pa rrënuara, është krenaria e një gjuhe e destinuar për pavdekësi. Fundja, *Atdheu* me rrënjenë në pellgje gjaku, edhe kur varret i radhit e stinët i mbledh, mbetet po ajo drithë fosforeshente shpirtrash të pavdekshëm.

Mbi të (pa)thënat e kohës³

Individualiteti i Ibrahim Kadriu i përngjet një udhëtarë të palodhur që përshkon hartën e *Atdheut*, me dëshirën për të lënë, qoftë dhe një gravim sado të vogël në çdo cep të kësaj harte, për të dekluaruar: “*Eca rrugicave nëpër kohë një trohë për t’prekur*”. Përmes vargjesh u bie kryq rrugëve të prera me të larta mure, zhibrohet nëpër kullat me frengji të fortë, dhe natyrisht, jo për të treguar se sa koleksion i thjeshtë antikitetesh na qenka - Historia, por për të dëshmuar se bota e krijuesit është fryma e *Atdheut* të tij. E nuk ka si të mos shprehet: “*Qëllimi ishte të udhëtoja gjatë.../ ...Të gropoja kohën e kujtimeve*” (60)⁴.

Në udhëtimet e pafundme, zbulon përmasat e rrëfimtarit të admirueshëm, me plotëni rrëfenjash që e kanë nismën në vargjet, si në “*Abetaren e birit tim, betohem dhe në Prophetarum*” (50)⁵. Vargjet e këtilla s’janë thjesht përzgjedhje, por përbledhje vlerash, edhe atëherë kur koha i digjet në bebëza. Veprat, përgjithësisht shënon një lloj - legjende të kohës, ndonëse “*Vjen koha ta shkelë kohën pa emrin e vet*”.

Bota përjetuese e poetit është drita zjarrnjellëse në sytë që shpërndajnë mall për të shkuarën, forcë për të ardhmen. Ngashëm si shikimi i vdekjes mbi kohën e ikur, lotin e shqetësimeve për dramat historike dhe nënkuqtohet, një gjendje shpirtërore brengosëse për të ardhmen, që përshkohet “*Me mungesë durimi shekullor mbi kalldrëme*”, ku fati dhe tragjikja e jetës lanë gjurmë betejash të ashpra.

Ibrahim Kadriu është poeti, për të cilin vendlindja është kurmi i tij, edhe atëherë kur këtë tokë e përshkon me këmbë të ngjyera në gjak, edhe atëherë kur *dielli pas shtatë bjeshkësh fshihet si kusar* dhe ke përballë *Kalin e Trojës me flakë ndër sy*. Dhe..., sërisht nuk të tremb asgjë, pasi je mësuar me ato faqe historish plot skelete e rrashta. Të kësaj tematike janë poezitë: “*Karadak male prej gjaku*” (42),⁶ “*Karadak skenë e hapët*” (43),⁷ “*Kohë e varur në litar*” (44 - 45),¹ etj.

¹ Ibrahim Kadriu, “Kohë e djegur në bebëza”, Prishtinë, 2015, f. 34.

² Po aty, f. 31.

³ Zejnepe Alili Rexhepi, “Pas gjurmëve të fjalës”, Tetovë, 2017.

⁴ Ibrahim Kadriu, “Kohë e djegur në bebëza”, Prishtinë, 2015, f. 60.

⁵ Ibrahim Kadriu, “Kohë e djegur në bebëza”, Prishtinë, 2015, f. 54.

⁶ Po aty, f. 42.

⁷ Po aty, f. 43.

Identiteti i zërit poetik të Ibrahim Kadriut, është përshkrim rrjedhash historike prej disa dekadash, e më larg në kohë, duke sajuar kështu tablonë e gjerë të dramës shqiptare, ku poeti gjen variantet e përshtatshmërisë së vetes në përmasat e pa formë të *dheut* të të parëve. Për këtë gjithmonë “*shikimi të ngjitet lart bjeshkëve ku presin/ ererat e veriut, ererat e jugut...*” E ti, i rrahu r furtunash betohesh në përjetësinë e dashurisë tënde për këtë dhe. Të tillë, formësohen poetët me ideale kombëtare.

Mjeshtëria e kumtit të fjalës dhe shpërthimi i ndjenjës, vijnë fort të ngjizura në poezinë e Kadriut. Ai, hollësish përshkruan skena prekëse me figura njerëzore që kryekëput i përkasin nënqiellit prej ku edhe frymëzohet. Është ky shtrat i traditës së vendbanimeve që përmenden, të cilat i nxisin dhjetëra arketipe dhembjesh e oshtimash, nëpër kohët e vështira të historisë dhe ditëve që i jeton poeti.

Aty ndodhen edhe gjurmët e zanafillës, vërtetuar përmes poeziës: “*Meshari*”.

Meshari

“*Kaluam përrën*

Erdhëm deri në një rrafshinë.

Nga aty vërejtëm gjurmët dhe aty

Gropuam shtatë pashë –

U ndalëm në fjalën tonë;

Shprishëm rrugët dhe vazhduam

të rritemi me gosinë e fjalës” (47)².

Një linjë paralele e studimit ideo - artistik të vargjeve, mundëson ecjen gjurmëve të identiteteve krijuese, me ç'rast, nën tisin biografik të soditjeve, gjenden fitjet lidhëse të poetit tonë me *Urtinë* e krijuesve të hershëm. Kjo traditë analize, mbi një lloj poezie, të mundëson qasje interpretimesh të frytshme, në suaza të krahasimeve të përtejkohës, ku dukshëm thellohet ideja se “*të gjitha kohët janë të sotme*”.

Imazhi konceptor i poetit mbi komb, gjuhë e atdhe, ngrihet mbi fatin tragjik të tokës sonë, andaj shpirti poetik dhe dashuria për *Atdhe* janë amalgamë e pashkëputshme ndonjëherë. Edhe në kërkimet letrare e përsiatjet më poliedrike që shtrihen mbi filozofinë, socialen, bibliken, historiken..., poeti dallohet me njohuritë e pafundme.

Poezi me karakter të theksuar moralizues, me një trashëgimi të begatshme letrare rrezonojnë me ndikim kulturash të shumta. Poezia e rrafshit social nuk është sajesë, as parafytyrim, por përjetim, venerim i përditshmërisë mbi çdo pëllëmbë të tokës shqiptare, mbi çdo cep të Atdheut, si përbushje drite e miliona syve. E pranon, është dobësi poetësh kjo: “*Dua që kur shkruaj bukur për popullin tim të shkruaj bukur, kur shkruaj për kombin tim, të shkruaj paq, sepse lumtur m'i luzmon èndrrat, m'i bleron èndjet, më jep forcë për të dashur këtë komb të lashtë, të barabartë me hyjnité...*³

Lirika e Ibrahim Kadriut e ruan pushtetin e krijuesit, edhe atëherë kur ai gjakon për të dialoguar për shqetësimet individuale dhe dramat kolektive. Janë poezi që ngërthejnë sfond të pasur lirik, ku konteksti i përgjithshëm historik, eksplorimet shpirtërore mbi hapësirat gjeografike, harkojnë universin e tërë kombëtar. Individualiteti përkapës i poetit e plotëson bindshëm universin e këtij lirizmi.

Lidhjet hierarkike ndërmjet thelbët tematik dhe shtojcave si nëntema periferike, e përvijojnë këtë vepër, po si qëndrimi i individit përballë procesit të migrimit që e shtynë autorin ta shprehë dashurinë për këtë truall, megjithëse jepet si formë mbizotëruese intelektuale dhe *Premtimet e kohës* nuk janë hiperbola, të

¹ Po aty, f. 54.

² Po aty, f. 47.

³ Ibrahim Kadriu, “Qasje të veprave të Ibrahim Kadriut”, Gjilan, 2015.

sajuara nga ëndrrat e poetit, por durimi i pa sfidueshëm i mbijetesës në kohën e pakohë. Poeti nuk pajtohet me fatin e dënimit me harresë. Ai kërkon katarzën e kohës, qoftë ajo edhe ndonjë kohë e djegur në bebëza.

Në vijim është analiza e një poezi - shkëputje e veçantë nga vëllimi poetik “Netët e Karadakut”, sepse më duket se pikërisht kjo poezi e përvijon atdhetarizmin e një poeti si Ibrahim Kadriu!

Fjala, refleks ngjarjesh historike

(Analizë poezisë “Karadak male prej gjaku”- Ibrahim Kadriu)

Duke e njobur krijimtarinë e begatshme, si në shumëllojshmëri zhanresh, po ashtu edhe në nivelin ideo - artistik, të shkrimitarit Ibrahim Kadriu, krejt lehtë mund ta gjesh atë të duhurën si art përmbushës, që e identifikon, jo vetëm afinititetin krijues, por tërësisht është në harmoni me kohën, me të cilën Ibrahim Kadriu bashkudhëtoi 70-të vite, madje duke shtuar këtu edhe kohën e brezit paraardhës. Pa dyshim, shkrimitarin e madh e përvijon edhe vizioni për kohën e pa jetuar, atë të ardhmen, të cilën ai e parandien më shumë se kushdo tjetër.

Atëherë, ç'rëndësi kanë vitet për fjalen e shkrimitarit, përderisa secili varg a vepër e tij të krijon opus të gjërë analize, e kënaqësi leximi?!

Mirëpo, nën ndikimin e ngjarjeve që ndodhën para ca ditësh në Kumanovë, pikërisht aty, te “Lagja e trimave” (2015), ku akoma plagët shqiptare kullojnë gjak... dhe duke lexuar veprën poetike të Ibrahim Kadriut “Netët e Karadakut”¹, më tërhoqi poezia “Karadak male prej gjaku” ku vihej në pah bota shpirtërore e poetit për historitë e vështira të këtij vendi, mbi bukuritë e të cilit furtunat e viteve kanë rrahu pamëshirshëm, e ky mbetet gjakimi jetik i poetit, tek shkruan:

“Kalimtarë mos u dehni me bukurinë e ahishtave
ato e kanë edhe shëmtinë e barit.
rrënjet u prekin thellë mbi kafka...”

Në këto vargje gjejmë fryshtësimë që rrjedhin furishëm si ngjizje situatash reale, portretizimi i të cilave u ripërtëri këtyre ditëve. Pamjet e sotme, me lodhjen dhe mjerimin e çdo shqiptari, me lotin e fëmijëve, gërmadhat e papërshkrueshme të shtëpive që nuk e përballuan dot gjuhën e flakëve..., mbeten po i njëjtë imazh që më 1969, s'them dot e shkroi, sepse në të vërtetë e skaliti pena e poetit Kadriu, vepra e të cilit na mblodhi sot këtu (Në gjilan, në përvjetorin e tij të 70-të), meqë vetëm duke lexuar ne e njobim të kaluarën tonë, e bëjmë të ndritur të sotmen për të gjetur shtigje rrugëtimesh për të nesërmen, ndonëse nuk duhet harruar kurrë eshtrat dhe gjakun e derdhur.

Në poezinë “Karadak male prej gjaku” çdo varg është përjetim, çdo fjala është histori më vete, çdo përshkrim është vetë skalitja e së kaluarës sonë që nuk duhet harruar, sepse atëherë kur e harrojmë, ajo na rikthehet me të reja tragjedi. Fuqia e fjaleve na shpëton nga ekzili i ndjenjave dhe nga tis’harresa e historisë. Poeti ynë nuk e mbron idenë se heshtja është flori, për të fjala është zjarri, shkëndijëzat e të cilit ndezin çdo zemër, është guri, forca që thyen portat e mbyllura, është amë uji, vrulli i së cilës përbys ligësitë... Për të, fjala është lufta dhe paqja e përbotshme. Fjala vret, por nuk vritet kurrë!

Vargjet e lindura nga këto situata shpërfqaqin më së miri spektrin tematik. Në këndvështrimin e së kaluarës dhe të sotmes, nuk e gjen dot *pragun dallues* për tragjeditë e këtyre trojeve. Edhe sot, sytë janë përthithja e dhimbjeve që të lënë pamjet gjithandej Karadakut, ndonëse sigurisht, jo e vetmja copë toke e mbarsur me ligësi e mëri shekujsh.

¹ Ibrahim Kadriu “Netët e Karadakut”, Poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1969.

Përmes figurave të mendimit, poeti e përshkruan kohëzgjatjen e asaj që e quajmë jetë, edhe atëherë kur për trishtimet e saj do të donte të dialogojë me *Danten*, sepse përmasat e jetës shqiptare e tejkalojnë *Purgatorin* e tij, pasi ai është pak për ta përshkruar dramën shqiptare, madje i tërë *Ferri* do të ishte i pamjaftueshëm. Poezia e Ibrahim Kadriut, edhe kjo e shkruar herët, mbetet kornizë poetike që nuk të tretet sysh gjatë stuhive të pluhurosura të kohëve në ecje.

“Poet, uroj që edhe më tej të vazhdoni të shkruani për dhimbjet e plagët shqiptare... E di se po, do ta bëni këtë, sepse shpirti i poetit është fanari që bredh dhe gjithmonë rri ndezur mbi çdo pëllëmbë të Atdheut. Atëherë, ju uroj edhe shumë vite jetë dhe jetëgjatësia le t’i bëhet dritë penës dhe veprës suaj”!¹

L I T E R A T U R A

Buxhovi, Jusuf.: “”Beteja e stinëve” në “Qasje veprave të Ibrahim Kadriut” (nga autorë shqiptarë dhe të huaj), Gjilan, 2015.

Kadriu, Ibrahim.: “Netët e Karadakut”, Poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1969.

Kadriu, Ibrahim.: “Kohë e djegur në bebëza”, Prishtinë, 2015.

Kamberi, Alush.: “Poezi e thjeshtë dhe rrëmbyese” në “Qasje veprave të Ibrahim Kadriut” (nga autorë shqiptarë dhe të huaj), Gjilan, 2015.

Musliu, Ramadan.: “Internacionaliteti i poezisë” në “Qasje veprave të Ibrahim Kadriut” (nga autorë shqiptarë dhe të huaj), Gjilan, 2015.

Nikë Berisha, Anton.: në “Qasje veprave të Ibrahim Kadriut” (nga autorë shqiptarë dhe të huaj), Gjilan, 2015.

“Qasje veprave të Ibrahim Kadriut” (nga autorë shqiptarë dhe të huaj), Gjilan, 2015.

Qosja, Rexhep.: “Dy obsione të një poeti”, në veprën “Qasje veprave të Ibrahim Kadriut” (nga autorë shqiptarë dhe të huaj), Gjilan, 2015.

Rexhepi Alili, Zejnepe.: “Pas gjurmëve të fjalës”, Tetovë, 2017.

“Qasje të veprave të Ibrahim Kadriut”, Gjilan, 2015.

Rexhepi Alili, Zejnepe.: “Lirika e kohës së pakohë”, në “Qasje veprave të Ibrahim Kadriut” (nga autorë shqiptarë dhe të huaj), Gjilan, 2015.

¹ Shënim: *Fjalë rasti e mbajtur në takimin letrar, me rastin e 70-të vjetorit të lindjes dhe 50-të vjetorit të krijimtarisë letrare, të shkrimitarit Ibrahim Kadriu, organizuar nga Ars Clubi “Beqir Musliu”, Gjilan, 18 maj 2015.